

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Pak ditë para datës 6 dhjetor, EU-Western Balkan summit, ja ku jemi sot në këtë sallë parlamenti, ku opozita lufton për të drejtën e fjalës, ku opozitës po tentojnë t'i mbyllin çdo hapësirë parlamentare. Pak ditë para samitit të datës 6 dhjetor po tentohet të zhduket pluralizmi në Shqipëri. Sot, pak ditë para samitit të liderëve të BEsë, po kalohen ligje dhe projekte, që e shkelin me të dyja këmbët MSA-në. Ndaj, data 6 dhjetor është e rëndësishme jo për qeverinë, ashtu sikurse ata e shesin, por për opozitën dhe qytetarët shqiptarë.

Kjo është një ditë e rëndësishme për t'u treguar liderëve të Europës realitetin në Shqipëri, që do të jemi në mbrojtje të vlerave evropiane, sepse të gjithë ne, këtu në këtë sallë, por edhe jashtë salle, e duam Shqipërinë si gjithë Europa dhe shqiptarët si të gjithë qytetarët europianë. Pak ditë nga data 6 dhjetor, kjo aulë, që duhet të ishte vendi ku flitet dhe mbrohen interesat e qytetarëve shqiptarë, sot përsëri u përlye nga fjalori i rrugës, banal, i turpshëm i Kryeministrit të vendit, që pret liderët e Europës. Sot ishte dita t'u kërkonte ndjesë, jo neve, por të gjithë qytetarëve shqiptarë, që e ka përdhosur këtë foltore, ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por, në tentativën e tij për të shpërqendruar vëmendjen nga skandali i radhës që po kaloni në këtë parlament, e bëri përsëri pis këtë foltore.

Vajzave të mia u kam kërkuar ta mbyllin televizorin sa herë ta shohin Edi Ramën, sepse kam frikë se dëgjojnë apo mësojnë atë që s'duhet, dhe jam e sigurt se kështu ndodh me çdo familje shqiptare. Por a është kjo zgjidhja? Jo, nuk është kjo zgjidhja. Edi Rama duhet përjashtuar! Ndaj, edhe ne, një grup deputetësh, kemi firmosur kërkesën, ku i kërkojmë Kuvendit që të marrë menjëherë masë disiplinore për të; ai nuk e ka vendin këtu. Edi Rama është nxitësi më i madh i dhunës, është turpi i këtij Kuvendi, mallkimi i këtij vendi, mallkim që duhet hequr sa më parë. Nuk do të merrem me Edi Ramën, sepse, në fund të fundit, ky është edhe qëllimi i tij, që të merremi me gjuhën e tij, që të merremi me mënyrën sesi ai ofendon dhe të tallet me këdo që mendon ndryshe nga ai, por do të merrem me skandalin e radhës, që bëhet, pikërisht, me urdhër të tij.

Sot tentuat të vinit limit kohor. Pse? Sepse kërkoni që ne të heshtnim dhe të mos demaskonim këtë akt korruptiv për një nga pasuritë më të mëdha e me rëndësi strategjike jo vetëm për Durrësin, por për Shqipërinë dhe rajonin, i cilësuar si i tillë edhe nga BE-ja. Ky projekt që doni të miratoni ju, nuk është

projekt porti turistik, sikurse ju pretendoni, por ashtu i keni vënë emrin thjesht për të fshehur gjurmët. Projekti, që po kërkoni të mashtroni, si projekt zhvillimi, është projekt për ndërtim pallatesh në buzë të detit, aty ku sot është porti, është projekt për të ndërtuar hotele dhe qendra tregtare, 99% e projektit është për ndërtim pallatesh. Unë i kam me vete tabelat e detajuara të projektit.

Në këtë projekt janë dy faza: faza e parë fillon në 2023-shin dhe mbaron në 2029-ën, ndërsa faza e dytë fillon në 2030-ën deri në 2043-shin. Çfarë do të ndërtohet deri në 2030-ën? 4 mijë apartamente. Pra, ai projekti i zhvillimit, me të cilin po kërkoni të mashtroni qytetarët shqiptarë, është thjesht projekt ndërtimi apartamentesh, që kanë filluar të shiten prej 1 viti nga një kompani në Durrës. Deri në vitin 2030 do të ndërtohen 150 dhoma hoteli, kurse të tjerat në fazën e dytë; 28 mijë do të jenë për mjedise tregtare. Nga vjen financimi i asaj që doni të na e shisni si një arritje shumë e madhe? Ai është vetëm 93% vetëfinancim i projektit nga shitja e apartamenteve apo qendrave tregtare, kurse ata aksionaret, që i përmendi ju se do të financojnë, do të derdhin më pak se 80 milionë euro, dhe pretendojnë se do të marrin edhe 80 milionë euro; ndërsa pjesa tjetër, pra 2,1 apo 2,2 miliardë euro, do të jetë nga vetëfinancimi.

Këtu kam edhe të ardhurat nga projekti, ku në total janë 3,2 miliardë euro të ardhura. Nga vijnë të ardhurat më të shumta? Vijnë nga shitja e apartamenteve. Pra, këta 2,2 miliardë euro vijnë nga shitja e apartamenteve. Ky është projekti që ju po na shisni si projekt madhor. Projekti është thjesht shitje apartamentesh, marrje të ardhurash, investohet nga shitja e apartamenteve e kështu me radhë. Shkatërrohet porti, u jepet atyre që nuk dihen dhe fshihen pas kompanive offshore dhe fitimet pastaj shkojnë këtu mbrapa, te këta që janë ulur pas meje, pra nuk ka lidhje me projekte zhvillimi. Me marrëveshjen që po kaloni sot, Edi Rama po heq portin e vetëm tregtar të një rëndësie strategjike, portë hyrëse për të gjithë Ballkanin, që po e mbyll për luksin e tij dhe për të vjedhur.

Pas së sotmes, ne do të mbetemi pa port tregtar. Pra, në vend që ta fuqizojë portin aktual të Durrësit (e përsëris, theksuar edhe nga Bashkimi European, si port i një strategjie të veçantë, prandaj akordoi edhe 28 milionë euro, të cilat i anuloi dje, do të ishte pika nga ku do të hynin të gjitha mallrat për Kosovën, për Serbinë e Jugut dhe deri në Hungari), Rama po heq dorë nga porti për disa pallate dhe një “Marinë” të vogël, shumë më e vogël sesa “Marina” e Malit të Zi. Pra, ai investitori i madh, sikurse jua përmenda më parë, do të investojë vetëm 80 milionë euro, duke lënë peng tokën, të cilën po e jep Edi Rama falas. Kjo është e njëjtë si për çdo projekt tjetër pallatesh në Tiranë, madje këtu fitimi është shumë herë më i madh sesa ky që do të marrë shteti shqiptar, ose, nëse i heqim taksat që ju i keni zeruar, shteti nuk ka asnjë fitim. Pra, nuk ka asnjë investim të huaj, ai është i vetëfinancuar.

Pra, jo vetëm porti që do të zhduket, por, sikurse e theksoi edhe kolegu im, Oerd Bylykbashi, edhe stacioni i trenit do të zhduket. Cili është mashtrimi tjetër në këtë projekt?! Nuk e ndërton Emaar-i, ashtu sikurse ju pretenduat në fillim dhe mashtruat, madje nuk e ndërton as kompania e Alabbar-it, por me një mashtrim tjetër që ju keni bërë, është një kompani tjetër si ajo me emrin kompanisë në Dubai dhe duket sikur po e bën ajo. Pra, sot parlamenti po kalon një marrëveshje me një kompani të regjistruar në QKB, me vetëm 10 mijë lekë kapital. Pra, keni shpallur investitor strategjik një kompani, e cila nuk ka asgjë dhe kjo kompani zotërohet nga një tjetër, e kështu me radhë për të fshehur aktivitetin. Së fundi, 60% të saj nuk e dimë se cilët janë, por të gjithë e kanë të qartë se cilët janë. Pra, është projekt personal i Edi Ramës dhe ju, të tjerëve, përderisa po mundoheni ta fshini.

Madje nuk ka as projekt të ri për portin e ri, siç pretendoni ju, ka vetëm një ministudim fizibiliteti, sipas të cilit do të harxhohen 2 miliardë euro për portin e ri. Po ku do t'i gjejë qeveria shqiptare këto para?! Ku është projekti? Për sa vite do ta ndërtojë? Çfarë do të ndodhë me Shqipërinë pa port? Qeveria thotë se nuk do ta heqë portin e Durrësit pa ndërtuar të riun, por unë kam një pyetje: po ku do jetë ai port, ku në 90% të sipërfaqes do të ndërtohen pallate?! Edhe sikur të lësh aty një vinç apo një kalatë, a mos ndoshta këtë do ta quani port?!

Qeveria shqiptare po e jep tokën falas dhe nuk po merr asgjë në këmbim. Në rastin më të mirë do të marrë 280 milionë euro fitim, por jep një tokë, e cila kushton 2 miliardë euro dhe ka hequr të gjitha taksat. Praktikisht vetëm nga taksat ky fitim bëhet zero, pra, thjesht po falin tokën. Interesi publik në këtë projekt është zero, ndërkohë që ne do të mbetemi pa port, i cili u shërben Shqipërisë dhe Kosovës dhe është një nga pasuritë tona më të mëdha strategjike.

Të dashur qytetarë,

Ky nuk është projekt zhvillimi, por është projekt shkatërrimi! Kjo është vjedhje dhe ky është projekt personal për të vjedhur. Ky është një projekt antishqiptar dhe antikombëtar! Edi Rama duhet ta urrejë shumë vendin e tij, që do të shkatërrojë çdo gjë që shqiptarët kanë ngritur me aq mund ndër shekuj, që shkatërroi teatrot, kinematë, stadiumet, stacionet e trenit, portet dhe çdo gjë më vlerë. Porti i Durrësit është grabitja më e madhe që i është bërë ndonjëherë Shqipërisë dhe ky projekt duhet ndalur, ndaj vota jonë është kundër.